



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Grupi ligjor
Fusha e studimit	Juridik
Institucioni që zhvillon procedurën e rekrutimit	Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nr. i Referencës	RN00018138
Kohëzgjatja e emërimit	Emërim me afat të pacaktuar
Data e njoftimit	03.07.2025
Afati për aplikim	04.07.2025 - 02.08.2025

Pozitat aktualisht të lira

Nr	Institucioni	Organizata / Vendi i punës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Pagat Koeficienti	Nr. i kërkuar
1	Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	Divizioni për Shqyrtimin e Ankesave / Prishtinë	Zyrtar i lartë për inspektim administrativ	Profesional 1	7.5	1



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Mbështet në mënyrë profesionale anëtarët e Këshillit në ushtrimin e funksionit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për nëpunësit civil dhe kandidatët për pranim në shërbimin civil;
2. Komunikon me zyrtarët përgjegjës të institucioneve të administratës publike, lidhur ankesat, duke dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë dhe kërkesa tjera sipas nevojës;
3. Mbledh dokumentacionin e nevojshëm lidhur me ankesën;
4. Pas kompletimit të lëndës me provat e nevojshme, njofton Kryetarin e Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me provat e lëndës, duke referuar lëndën në kolegji, si dhe jep mendimin juridik lidhur me kualifikimin juridik të lëndës;
5. Përgatit draft vendimin lidhur me ankesën;
6. Inspekton ecurinë e zbatimit të vendimeve të Këshillit në raport me ankesat e vendosura.
7. Nën mbikëqyrjen e udhëheqësit të drejtpërdrejtë merr veprimet ligjore dhe kujdeset për përgatitjen e lëndës në rast të mos zbatimit të vendimeve në pajtueshmëri me Ligjin për Këshillin;
7. Krijon, mirëmban dhe përditëson regjistrin me të dhënat të sakta lidhur me procedurën e zbatimit të vendimeve të Këshillit;
8. Pranon Aktvendimi e Gjykatës lidhur me paditë/ankesat e ushtruar nga pala kundër vendimeve të këshillit dhe përgatit përgjigjen në padi/ankesë;
9. Me autorizim të Kryetarit të Këshillit përfaqëson Këshillin në gjykatë ku Këshilli është palë në procedurë lidhur me ankesat e vendosura;
10. Nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave dhe udhëheqësin e drejtpërdrejtë, përgatit ankesat për Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër aktgjykimeve/aktvendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe përgatit kërkesat për rishqyrtim të jashtëzakonshëm për Gjykatën Supreme ndaj vendimeve të gjykatave të shkallës më të ulët;
11. Përgatitë parashtresa të ndryshme që janë nevojshme e të cilat kanë ndërlidhje me përfaqësimin e Këshillit në gjykata;
12. Kryen edhe punë të tjera varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të drejtpërdrejtë.

2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Fakultet Juridik
- **Kërkesat specifike:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase.
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Njohuri të thella dhe të specializuara në fushën profesionale specifike.
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë.
- Njohuri të gjëra të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike.
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës.
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave.
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale.
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- Njohja e gjuhëve të huaj (e preferueshme).

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer dhe noterizuar të përvojës të lëshuar nga punëdhënësi përkatës.
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.
- Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se (6) muaj nga data e lëshimit.
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (Kandidatët që janë të punësuar apo kanë qenë të punësuar në institucione publike).

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 17/08/2025, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Kriteret specifike shtesë

Nuk ka

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

- Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, njësia përgjegjëse bën verifikimin para emërimit me qëllim të vërtetimit se kandidatët vazhdojnë të plotësojnë kriteret e konkursit, përmes dokumenteve në origjinal apo të njësuar me origjinalin.
- Kandidatët fitues do të kenë mundësinë e përzgjedhjes së pozitës së lirë sipas radhitjes përfundimtare.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen